

UDHËZIM
Nr.2210, datë 25.11.2010

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR.618, DATË 7.9.2006 “PËR PËRCAKTIMIN E
KRITEREVE TË DOKUMENTACIONIT DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË PAGESËS PËR
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”, TË NDRYSHUAR**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 7.9.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 7.9.2006, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuar.

2. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.618, datë 7.9.2006, është 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2 të vendimit dhe 9500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj për kujdestarin.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe e shtrin efektin nga data 1.12.2010.

**MINISTRI I PUNËS ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Spiro Ksera**